



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

---

**RREGULLORE (QRK) Nr. 06/2017 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR BARAZI GJINORE<sup>1</sup>**

**REGULATION (GRK) No. 06/2017 ON INTERNAL ORGANIZATION AND SYSTEMATIZATION OF JOBS IN AGENCY ON GENDER EQUALITY<sup>2</sup>**

**UREDBA (VRK) Br. 06/2017 O UNUTRAŠNJOJ ORGANIZACIJI I SISTEMATIZACIJI RADNIH MESTA U AGENCIJI ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore QRK - Nr. 06/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematzimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Barazi Gjinore, është miratuar në mbledhjen e 145 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.04/145, datë 15.05.2017,

<sup>2</sup> Regulation GRK - No.06/2017 on Internal Organization and Systematization of Jobs in Agency on Gender Equality, was approved on 145 meeting of the Government of Kosovo, with the decision No.04/145, date 15.05.2017,

<sup>3</sup> Uredba VRK-Br.06/2017 Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematzaciji Radnih Mesta u Agenciji za Ravnopravnost Polova , usvojen je na 145 sednicu Vlade Kosova, odlukom br. 04/145, datum 15.05.2017.

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p><b>Qeveria e Republikës së Kosovës,</b><br/>Në mbështetje të nenit 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 9 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/26 qershor 2015), neni 33 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore (Gazeta Zyrtare, nr 82/21, tetor 2010), si dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Venleve të Punës në Administratën Shtetërore, në pajtim me nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011(Gazeta Zyrtare, nr 15/12, shtator 2011),</p> <p>Miratton:</p> <p><b>RREGULLORE (QRK) Nr. 06/2017 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR BARAZI GJINORE</b></p> <p><b>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1</b><br/><b>Qëllimi</b></p> <p>Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e</p> | <p><b>Government of the republic of Kosovo,</b><br/>Pursuant to the Article 93(4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Article 9 paragraph 3 of the Law No. 05/L-020 on Gender Equality, (Official Gazette of the Republic of Kosovo No. 16/26 June 2015), Article 33 of the Law No. 03/L-189 on the State Administration (Official Gazette, no. 82/21, October 2010), as well as pursuant to the Regulation No. 09/2012 on Standards of Internal Organization and Systematization of Jobs in the State Administration, pursuant to the Article 19 (6.2) of the Regulation No. 09/2011 on the Rules and Procedures of the Republic of Kosovo (Official Gazette, no. 15/12, September 2011),</p> <p>Approves:</p> <p><b>REGULATION (GRK) No.06/2017 ON INTERNAL ORGANIZATION AND SYSTEMATIZATION OF JOBS IN THE AGENCY FOR GENDER EQUALITY</b></p> <p><b>CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1</b><br/><b>Purpose</b></p> <p>The purpose of this Regulation is to determine</p> | <p><b>Vlada Republike Kosova,</b><br/>U skladu sa članom 93(4) Ustava Republike Kosova, članom 9. stav 2. Zakona br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova, (Službeni list Republike Kosova br. 16/26 jun 2015), članom 33. Zakona br. 03/L-189 o državnoj administraciji (Službeni list, br. 82/21, oktobar 2010), kao i u skladu sa Uredbom br. 09/2012 o standardima unutrašnjeg organizovanja i sistematizaciji radnih mesta u državnoj upravi, u skladu sa članom 19. (6.2) Pravilnika o Radu Vlade Republike Kosovo br. 09/2011 (Službeni list, br. 15/12, septembar 2011),</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>UREDBE (VRK) Br.06/2017 O UNUTRAŠNJOJ ORGANIZACIJI I SISTEMATIZACIJI RADNIH MESTA U AGENCIJI ZA RAVNOPRAVNOST POLOV</b></p> <p><b>POGLAVLJE I – OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1</b><br/><b>Cilj</b></p> <p>Ova uredba ima za cilj određivanje</p> |
|---|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>përgjegjësi dhe organizimin e brendshëm të Agjencisë për Barazi Gjinore (më tutje ABGJ).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2<br/>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga ABGJ.</p> <p>2. Mandati, detyrat, dhe përgjegjësitë e ABGJ-së janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3<br/>Përkufizimet</b></p> <p>Të gjitha përkufizimet e përdorura në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore janë të vleshme dhe për këtë rregullore</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II STRUKTURA ORGANIZATIVE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4<br/>Struktura organizative e ABGJ-së</b></p> <p>1. Agjencia për Barazi Gjinore është agjenci</p> | <p>the responsibilities and internal organization of the Agency on Gender Equality (hereinafter AGE).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2<br/>Scope</b></p> <p>1. This Regulation is implemented by AGE.</p> <p>2. Mandate, duties and responsibilities of AGE are determined in the Law No. 05/L-020 on Gender Equality.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3<br/>Definitions</b></p> <p>All definitions used in the Law No. 05/L-020 on Gender Equality shall apply to this Regulation.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II ORGANIZATIONAL STRUCTURE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4<br/>AGE organizational structure</b></p> <p>1. Agency on Gender Equality is an executive</p> | <p>odgovornosti i unutrašnju organizaciju Agencije za ravnopravnost polova (u daljem tekstu ARP).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2<br/>Delokrug</b></p> <p>1. Ova Uredba se sprovodi od strane ARP-a.</p> <p>2. Mandat, obaveze i odgovornosti ARP-a su određene Zakonom br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3<br/>Definicije</b></p> <p>Sve definicije navedene u Zakonu br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova su važeće i za ovu uredbu.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II ORGANIZACIONA STRUKTURA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4<br/>Organizaciona struktura ARP-a</b></p> <p>1. Agencija za ravnopravnost polova je</p> |
|---|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>ekzekutive, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>2. Për zbatimin dhe kryerjen me efikasitet të mandatit, përgjegjësi, dhe detyrave të punës, ABGJ përbëhet nga:</p> <p>2.1. Zyra e Kryeshefit/es të Agjencisë.</p> <p>2.2. Divizioni për Legjislacion.</p> <p>2.3. Divizioni për Bashkëpunim dhe Koordinim.</p> <p>2.4. Divizioni për Monitorim, Raportim dhe Huluntim.</p> <p>2.5. Divizioni për Administratë, Buxhet dhe Financa.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Agjenci është njëzetë e një <b>(21)</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b><br/><b>Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e e Agjencisë për Barazi Gjinore</b></p> <p>1. Kryeshefi/a Ekzekutive e ABGJsë është nëpunësi/ja më i/e lartë civil, dhe udhëheqësi/ja më i/e lartë administrativ/e dhe financiar i/e ABGJ, i/e cili/a i raporton drejtpërdrejtë Kryeministrit.</p> | <p>agency within the Office of the Prime Minister.</p> <p>2. Efficiently implement and fulfil its mandate, responsibilities and work duties, AGE is composed of:</p> <p>2.1. Office of the Chief Executive of the Agency.</p> <p>2.2. Division for Legislation.</p> <p>2.3. Division for Cooperation and Coordination.</p> <p>2.4. Division for Monitoring, Reporting and Research.</p> <p>2.5. Division for Administration, Budget and Finance.</p> <p>3. Number of employees in the Agency is twenty one <b>(21)</b>.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b><br/><b>Chief Executive Officer of the Agency for Gender Equality</b></p> <p>1. AGE's Chief Executive Officer is the highest civil servant and highest administrative and financial manager of AGE, who shall directly report to the Prime Minister.</p> | <p>izvršna agencija, u okviru Kancelarije Premijera.</p> <p>2. Za efikasno sprovođenje i izvođenje mandata, odgovornosti i radnih obaveza, ARP se sastoji od:</p> <p>2.1 Kancelarije Izvršnog/e šefa/ice Agencije.</p> <p>2.2. Divizije za Zakonodavstvo.</p> <p>2.3. Divizije za saradnju i koordinaciju.</p> <p>2.4. Divizija za nadgledanje, izveštavanje i istraživanje.</p> <p>2.5. Divizija za upravu, budžet i financije.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Agenciji je dvadeset jedan <b>(21)</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b><br/><b>Izvršni/a šef/ica Agencije za ravnopravnost polova</b></p> <p>1. Izvršni/a šef/ica ARP-a je najviši/a visoki/a službenik/ca, i najviši/a administrativni/a i finansijski/a rukovodilac/teljka ARP-a, koji/koja izveštava direktno Premijeru.</p> |
|---|---|--|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>2.Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e i/e ABGJ-së udhëheq me divizionet përkatëse të ABGJ-së në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, ligjet përkatëse për administratë publike, shërbimin civil, dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës.</p> <p>3.Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e i/e ABGJ-së ka këto obligime.</p> <p>3.1.Administrimin dhe drejtimin e përgjithshëm të Agjencisë dhe garantimin e zbatimit të funksioneve që i janë besuar atij/asaj;</p> <p>3.2.Sigurimin e politikave publike, akteve normative, udhëzimeve të përshtatshme, të sakta e të paanshme, rekomandimeve dhe këshillave profesionale për Qeverinë e Republikës së Kosovës që promovojnë, dhe sigurojnë zbatimin e parimeve të barazisë gjinore në Kosovë;</p> <p>3.3.Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë dhe nxjerrjen e akteve administrative për çështje të cilat lidhen me funksionet e tij/saj;</p> <p>3.4.Menaxhimin efikas dhe të suksesshëm të burimeve financiare që i ndahen Agjencisë nga buxheti i Kosovës, përfshirë dhe subvecionet, si dhe mjeteve financiare që përfitohen nga fondet e donatorëve përmes projekteve dhe</p> | <p>2.Chief Executive Officer of AGE shall operate with relevant divisions of AGE pursuant to the Law on Gender Equality, relevant laws for public administration, civil service and other legal acts and bylaws of the Republic of Kosovo.</p> <p>3.Chief Executive Officer of AGE shall have the following obligations:</p> <p>3.1.Overall administration and management of Agency and guaranteeing the implementation of functions vested on him/her;</p> <p>3.2.Ensuring public policies, normative acts, appropriate, accurate and impartial instructions, recommendations and professional advices for the Government of the Republic of Kosovo that promote and ensure the implementation of gender equality principles in Kosovo;</p> <p>3.3.Organization and functioning of Agency and issuance of administrative acts for issues related to its functions;</p> <p>3.4.Efficient and successful management of financial sources allocated to the Agency from the Kosovo budget, including subsidies, as well as financial means from donor funds through various</p> | <p>2.Izvršni/a šef/ica ARP-a upravlja relevantne divizije ARP-a u skladu da Zakonom o ravnopravnosti polova, relevantnim zakonima za javnu administraciju, i ostalim zakonskim i podzakonskim aktima Republike Kosovo.</p> <p>3. Izvršni/a šef/ica ARP-a ima ove obaveze:</p> <p>3.1.Opšte upravljanje i vođenje Agencije i garantovanje sprovođenja funkcija koje su njemu/njoj poverili;</p> <p>3.2.Obezbeđivanje javnih politika, normativnih, prikladnih smernica, tačnih i nepristranih, preporuka i stručnih saveta za Vladu Republike Kosovo da promovišu, i obezbeđuju sprovođenje načela ravnopravnosti polova na Kosovo;</p> <p>3.3.Organizacija i funkcionisanje Agencije i izdavanje administrativnih akata o pitanjima koja se tiču njegove/njene funkcije;</p> <p>3.4.Efikasno i uspešno upravljanje finansijskih izvora koji su dodeljeni Agenciji iz budžeta Kosova, obuhvatajući i subvencije, kao i finansijska sredstva koja se stiču putem fondova donatora i to</p> |
|---|--|--|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>programeve të ndryshme;</p> <p>3.5.Zbatimin e politikave jodiskriminuese brenda Agjencisë;</p> <p>3.6.Mbikëqyrë dhe koordinon punën e Departamenteve të Agjencisë;</p> <p>3.7.Bashkëpunon dhe koordinon punën me institucionet publike, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare për sigurimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave për barazi gjinore dhe integrimin e parimeve të barazisë gjinore në programet dhe projektet e ndërmarra;</p> <p>3.8.Kryen detyrat dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, për pozitën e larta drejtuese.</p> <p>4.Për mbarëvajtjen e punëve dhe përgjegjësi të Kryeshefit/es Ekzekutiv/e të ABGJ-së, funksionon Zyra e Kryeshefit /es Ekzekutiv/e.</p> <p>5. Zyra e Kryeshefit/es Ekzekutiv/e përbëhet nga:</p> <p>5.1. Asistenti/ja Ekzekutiv/e</p> <p>5.2. Zyrtari/ja Çertifikues/e</p> <p>5.3. Zyrtari/ja i/e Prokurimit</p> <p>5.4.Zyrtari/ja i/e Marrëdhënies me</p> | <p>projects and programmes;</p> <p>3.5.Applying non-discriminatory policies within the Agency;</p> <p>3.6.Supervising and coordinating the work of Departments of Agency;</p> <p>3.7.Cooperates and coordinates work with public institutions, civil society and international organization for ensuring the implementation of legislation and policies for gender equality and integration of gender equality principles in programmes and projects undertaken;</p> <p>3.8.Performs other duties and responsibilities set forth in the applicable legislation for senior managing positions.</p> <p>4.The Office of the Chief Executive Officer is responsible for the progress of works and responsibilities of the Chief Executive Officer of AGE.</p> <p>5.Office of Chief Executive Officer is composed of:</p> <p>5.1.Executive Assistant;</p> <p>5.2.Certifying Officer;</p> <p>5.3.Procurement Officer;</p> <p>5.4.Public Relations Officer.</p> | <p>putem različitih projekata i programa;</p> <p>3.5.Sprovođenje ne-diskriminativnih politika unutar Agencije;</p> <p>3.6.Nadgleda i koordinira rada odeljenja Agencije;</p> <p>3.7.Sarađuje i koordinira rad sa javnim institucijama, civilnim društvom i međunarodnim organizacijama za obezbeđivanje sprovođenja zakonodavstva i politika za ravnopravnost polova i integrisanje načela ravnopravnosti polova u preduzetim programima i projektima;</p> <p>3.8.Vrši ostale obaveze i odgovornosti određene važećim zakonodavstvom, za visoke položaje upravljanja.</p> <p>4.Za dobar tok poslova i odgovornosti Izvršnog/e šefa/ice ARP-a, funkcionise Kancelarija Izvršnog/e šefa/ice.</p> <p>5.Kancelarija Izvršnog/e šefa/ice sastoji se od:</p> <p>5.1. Izvršni/a Pomoćnik/ca</p> <p>5.2. Službenik/ca za sertifikovanje</p> <p>5.3. Službenik/ca za nabavke</p> <p>5.4. Službenik/ca za odnose sa javnošću.</p> |
|---|--|---|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>Publikun.</p> <p>6.Pozicionet në paragrafin 5 të kësaj rregulloreje i përgjigjen drejtpërdrejtë Kryeshefit/es Ekzekutiv/e të ABGJ-së dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i kryejnë sipas legjislacionit në fuqi për këto fusha.</p> <p>7.Emërimi dhe shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë i Kryeshefit/es Ekzekutiv/e rregullohen me dispozitat relevante në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b><br/><b>Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve në Zyrën e Kryeshefit/ese Ekzekutive</b></p> <p>1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Asistentit/es Ekzekutiv/e:</p> <p>1.1.Siguron mbeshtetje të përgjithëshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimit, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme</p> <p>1.2.Komunikon direkt dhe në emër të mbikqyrësit me njësitë organizative brenda institucionit për çështje të inicuar nga mbikqyrësi;</p> | <p>6.Positions referred to in paragraph 5 of this Regulation shall directly report to the Chief Executive Officer of AGE and shall perform their duties and responsibilities in compliance with the legislation applicable to such fields.</p> <p>7.Appointment and dismissal, functions and responsibilities of the Chief Executive Officer shall be regulated by relevant applicable provisions in the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b><br/><b>Duties and responsibilities of employees in the Office of the Chief Executive Officer</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Executive Assistant:</p> <p>1.1. Ensures general administrative and technical support, including official mail, telephone calls, scanning, faxing and copying documents, filling expenditures reports and preparing documents for various meetings;</p> <p>1.2. Communicates directly and on behalf of the supervisor with organizational units within the institution for issues initiated by the supervisor;</p> | <p>6.Položaji u stavu 5 ove uredbe direktno odgovaraju Izvršnom/oj šefu/ici ARP-a i obaveze i odgovornosti istih vrše se prema važećem zakonodavstvu za ove oblasti.</p> <p>7.Imenovanje i otpuštanje, funkcije i odgovornosti Izvršnog/e šefa/ice regulišu se relevantnim odredbama na snazi u Republici Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b><br/><b>Obaveze i odgovornosti zaposlenih u kancelariji Izvršnog/e šefa/ice</b></p> <p>1.Obaveze i odgovornosti Izvršnog/e Pomoćnika/ce:</p> <p>1.1.Obezbeđivanje opšte administrativne i tehničke podrške obuhvatajući službenu poštu, telefone, skeniranje, slanje faksa i kopiranje dokumenata, ispunjavanje izveštaja rashoda kao i izrada dokumenata za različite sastanke;</p> <p>1.2.Direktno komunicira i u ime nadzornika sa organizacionim jedinicama unutar institucije o pokrenutim pitanjima od strane nadzornika;</p> |
|--|---|---|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>1.3.Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe emailt për mbikqyrësin;</p> <p>1.4. Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;</p> <p>1.5.Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikqyrësit;</p> <p>1.6. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikqyrësin si dhe ndihmon në zgjedhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;</p> <p>1.7.Ndihmon mbikqyrësin në caktimin dhe koordinimin e takimeve të ndryshme dhe të marrë pjesë në takime nëse është e nevojshme;</p> <p>1.8. Kryen dhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit/es për</p> | <p>1.3.Prepare and modifies documents, including correspondence, reports, memoranda and emails for the supervisor;</p> <p>1.4.Receives and distributes the correspondence for the supervisor and takes care on the progress;</p> <p>1.5. Stores and maintains electronic system and hard copies of documents and files of the office of supervisor;</p> <p>1.6. Manages the schedule of meetings and other events for the supervisor, as well as helps in solving administrative and technical problem;</p> <p>1.7. Assists the supervisor in assigning and coordinating different meetings and participates in meetings, if necessary;</p> <p>1.8. Performs other duties in compliance with laws and regulations which may be reasonably required by the supervisor.</p> <p>2.Duties and responsibilities of the Certifying Officer:</p> | <p>1.3.Priprema i modifikuje dokumente uz obuhvatanje korespondencije, izveštaje, memorandumume i elektronsku poštu za nadzornika;</p> <p>1.4. Prima i raspodeljuje korespondenciju za nadgledanje i brine se o njenom dobrom toku;</p> <p>1.5.Čuva i održava elektronski sistem i fizičke kopije dokumenata i dosijea kancelarije nadzornika;</p> <p>1.6.Upravlja kalendar sastanaka i ostalih dešavanja za nadzornika kao i pomaže tokom rešavanja nekog administrativnog ili tehničkog problema;</p> <p>1.7.Pomaže nadzornika u određivanju i koordinaciju različitih sastanaka i učestvuje na sastancima ako je to potrebno;</p> <p>1.8.Vrši i ostale obaveze u skladu sa zakonom i uredbama koje se mogu zahtevati povremeno na razuman način od strane nadzornika.</p> <p>2.Obaveze i odgovornosti Službenika/ce za sertifikaciju:</p> |
|---|---|--|



|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>Çertifikim:</p> <p>2.1.Në pajtim me mbikqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit/sectorit dhe jep rekomandime lidhur me objektivat e njësisë;</p> <p>2.2.Udhëheq grupet punuese kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën profesionale specifike si dhe ndihmon stafin në ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;</p> <p>2.3.Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të divizionit dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;</p> <p>2.4.Çertifikon realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore të institucionit;</p> <p>2.5.Siguron që kushtet e zbatueshmërisë të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës;</p> <p>2.6.Siguron që shpenzimi i parasë publike sipas një kontrate publike të bëhet në</p> | <p>2.1.In compliance with the supervisor, drafts work plans for the implementation of duties assigned based on division/sector objectives and provides recommendations about the unit objectives;</p> <p>2.2. Leads working groups when required, and performs specialized duties in the specific professional field, as well as assists the staff in executing their duties and responsibilities;</p> <p>2.3.In cooperation with the supervisor, analyses and assesses the accomplishment of objectives and work plan of the division and drafts reports on the progress achieved and recommends improvements, if necessary;</p> <p>2.4.Certifies all budget expenditures of the institution;</p> <p>2.5.Ensures that conditions of implementation of a public contract are fulfilled prior to the payment or authorization of payments according to the contract;</p> <p>2.6.Ensures that public funds are spent according to a public contract in compliance with the applicable rules, and</p> | <p>2.1.U saglasnosti sa nadzornikom izrađuje planove rada za sprovođenje obaveza određenih na osnovu objekta divizije/sektora i daje preporuke vezano za objektivne jedinice;</p> <p>2.2.Vodi radne grupe kada se zahteva i vrši ostale specijalizovane obaveze u specifičnim stručnim oblastima kao i pomaže osoblje u izvršenju njihovih obaveza i odgovornosti;</p> <p>2.3.U saradnji sa nadzornikom analizuje i procenjuje objektivne i plan rada divizije i izrađuje izveštaje o stečenom napretku i preporučuje popravke ako se to zahteva;</p> <p>2.4.Overava ostvarivanje svih budžetskih rashoda institucije;</p> <p>2.5.Osigurava da uslovi sprovođenja jednog javnog ugovora su ispunjeni pre izvršenja ili ovlašćenja isplata prema ugovoru;</p> <p>2.6.Osigurava da se potrošnja javnog novca vrši u skladu sa propisima na snagu i da je nabavka u skladu sa Zakonom o</p> |
|--|--|--|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>pajtim me rregullat në fuqi dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik;</p> <p>2.7.Siguron që janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve;</p> <p>2.8.Kryen dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregullore të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi.</p> <p>3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit/es për Prokurim:</p> <p>3.1.Përgatit materialet standarde, varësisht nga metoda e prokurimit;</p> <p>3.2.Përgatit dokumentacionin dhe ftesa për oferta për tenderë dhe dërgimin e tyre për shpallje në mjetet e informimit;</p> <p>3.3.Pranon fletëpagesa për material të tenderëve në listë dhe regjistrimi i të gjitha kompanive që marrin materialin e tenderit në listën e hartuar për këtë qëllim;</p> <p>3.4.Kontrollon faturat në pajtim me</p> | <p>that procurement is in compliance with the Law on Public Procurement;</p> <p>2.7.Ensures that contract conditions have been fulfilled prior the payment and that the request for payment is coded in appropriate expenditure item;</p> <p>2.8.Performs other duties in compliance with the laws and regulations that may be reasonably required by the supervisor.</p> <p>3.Duties and responsibilities of Procurement Officer:</p> <p>3.1.Prepare standard materials, depending on the procurement method;</p> <p>3.2.Prepare documentation and invitations for tender bids and submits them to information means;</p> <p>3.3.Receives payment slips for tender material contained in the list and registration of all companies receiving the tender material in the list compiled for this purpose;</p> <p>3.4.Checks invoices in compliance with</p> | <p>javnim nabavkama;</p> <p>2.7.Osigurava da su se ispunili uslovi ugovora pre nego što se izvrši isplata i da je zahtev za isplatu kodiran u relevantnoj stavci;</p> <p>2.8.Vrši i ostale obaveze u skladu sa zakonom i uredbom koje se mogu zahtevati povremeno na razuman način od strane nadzornika;</p> <p>3.Obaveze i odgovornosti Službenika/ce za nabavke:</p> <p>3.1.Priprema standardnih materijala, zavisno od metoda nabavke;</p> <p>3.2.Priprema dokumentaciju i pozive za ponude za tendere i njihovo slanje na objavljivanje putem sredstava informisanja;</p> <p>3.3.Prima uplatnice za materijal tendera na listi i registrovanje svih kompanija koje dobijaju materijale tendera u listi izrađenoj za ove svrhe;</p> <p>3.4.Kontroliše račune u skladu sa</p> |
|--|---|---|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>kushtet e kontratës, me shënimet mbi mallrat e pranuar të nënshkruara nga nëpunësi i emëruar për pranimin e mallrave, përgatit dokumentacionin për pagesë dhe dërgon lëndët për ekzekutim;</p> <p>3.5.Pranon oferta nga kompanitë në kohën e paraparë në tender, dokument dhe merr pjesë në përgatitjen e hapjes së ofertave;</p> <p>3.6.Merr pjesë në përgatitjen e procedurave të vlerësimit të ofertave;</p> <p>3.7.Mban të dhëna të detajuara për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar;</p> <p>3.8.Kryen detyra të tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.</p> <p>4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit/es për Marrdhënje me Publikun:</p> <p>4.1.Planifikon, zhvillon dhe zbaton strategji për informimin e publikut mbi planet dhe programet e ABGJ-së;</p> <p>4.2.Përgatit Buletin e ABGJ-së në bashkëpunim me departamentet e ABGJ-</p> | <p>the terms of the contract, records on received goods signed by the official appointed for receiving goods, prepares documentation for payment and submits cases for execution</p> <p>3.5.Receives offers from companies at the time foreseen in the tender, document and participates in preparing bids opening;</p> <p>3.6.Participates in preparing bid assessment procedures;</p> <p>3.7.Keeps detailed data on all participating bidders for actions and decisions taken, as well signature of comments by all members;</p> <p>3.8.Performs other duties in compliance with the job purpose, which may be required by the supervisor;</p> <p>4.Duties and responsibilities of the Public Relations Officer:</p> <p>4.1.Plans, develops and implements the strategy on public information on AGE plans and programmes;</p> <p>4.2.Prepare AGE's Bulletin in cooperation with AGE departments,</p> | <p>uslovima ugovora, sa beleškama o primljenoj robi potpisane od strane imenovanog službenika za prijem robe, priprema dokumentaciju za isplatu i prosleđuje predmet za izvršenje;</p> <p>3.5.Prima ponude od strane kompanija u predviđenom vremenu na tenderu, dokumente i učestvuje u pripremi otvaranja ponuda;</p> <p>3.6.Učestvuje na pripremi postupaka procene ponuda;</p> <p>3.7.Vodi detaljne podatke za sve ponuđače učesnike i donete odluke, kao i potpisivanje komentara od strane svakog člana;</p> <p>3.8.Vrši i ostale obaveze u skladu sa zakonom i uredbom koje se mogu zahtevati povremeno na razuman način od strane nadzornika.</p> <p>4.Obaveze i odgovornosti Službenika/ce za odnos sa javnošću:</p> <p>4.1.Planira, razvija i sprovodi strategiju za informisanje javnosti i programa ARP-a;</p> <p>4.2.Priprema bilten ARP-a, u saradnji sa odeljenjima ARP-a; bira članke/artikle,</p> |
|--|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>së, përzgjedh artikuj/shkrime, shkruan artikuj dhe redakton materialet e Buletinit;</p> <p>4.3.Mbikëqyr dhe siguron aprovimin për paraqitjen grafike dhe përmbajtjen e Buletinit para botimit;</p> <p>4.4.Mbikëqyr procesin e botimit dhe siguron botimin cilësor të Buletinit;</p> <p>4.5.Përgatit dhe mbikëqyr përgatitjen dhe prodhimin e broshurave, fletushkave, videove promocionale, fotografive dhe programeve multimediale;</p> <p>4.6.Kontribuon dhe ndihmon në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit si p.sh. “16 ditët e aktivizmit”, fushata kundër kancerit, etj.;</p> <p>4.7.Harton fjalime, artikuj dhe redakton prezantime të punonjësve të ABGJ-së;</p> <p>4.8.Mirëmban faqen elektronike të ABGJ-së dhe e përditëson atë me informacione, raportime, dhe paraqitje vizuale të aktiviteteve;</p> <p>4.9.Përcjell, analizon dhe përgatit përmbledhjen ditore të medias;</p> <p>4.10.Hulumton, përgatit dhe shpërndan</p> | <p>selects articles/texts, writes articles and edits Bulletin materials;</p> <p>4.3.Supervises and ensures the approval of graphical content and content of Bulletin prior to publication;</p> <p>4.4.Supervises the publication process and qualitative publication of the Bulletin;</p> <p>4.5.Prepare and supervises the development of brochures, flyers, promotional videos, photos and multimedia programs.</p> <p>4.6.Contributes and helps in organization of awareness-raising campaigns, such as e.g. “16 days of activism“, campaigns against cancer, etc.;</p> <p>4.7.Compiles speeches, articles and edits presentations of AGE employees;</p> <p>4.8.Maintains AGE website and updates it with information, reports and visual presentation of activities;</p> <p>4.9.Follows, analyses and prepares daily summary of media;</p> <p>4.10.Researches, prepares and distributes</p> | <p>piše članke i uređuje materijale Biltena;</p> <p>4.3.Nadgleda i obezbeđuje odobrenje za grafičke prikaze i sadržaj Biltena pre publikacije;</p> <p>4.4.Nadgleda proces izdavanja i obezbeđuje kvalitetno izdavanje Biltena;</p> <p>4.5.Priprema i nadgleda pripremu i proizvodnju brošura, letaka, promotivnih snimaka, fotografija i multimedijaskih programa;</p> <p>4.6.Doprinosi i pomaže u organizovanju kampanja za podizanje svesti kao npr: “16 dana aktivizma“, kampanja protiv raka, itd.;</p> <p>4.7.Priprema govore, članke i uređuje prezentacije zaposlenih u ARP-u;</p> <p>4.8.Održava elektronsku stranicu ARP-a i ažurira je sa informacijama, izveštajima, i vizuelnim prikazima aktivnosti;</p> <p>4.9.Prati, analizuje i priprema dnevni pregled medija;</p> <p>4.10.Istražuje, priprema i raspodeljuje</p> |
|---|---|--|

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>materiale dhe komunikata për median;</p> <p>4.11.Mban lidhje dhe u përgjigjet pyetjeve, hulumtimeve të medias, individëve dhe organizatave të ndryshme përmes konferencave të shtypit, përmes e-mailit apo telefonit;</p> <p>4.12.Menaxhon, përditëson dhe angazhohet me përdoruesit e medias sociale si Twitter dhe Facebook;</p> <p>4.13.Asiston dhe koordinon ngjarje të veçanta si konferenca, ekspozita, etj;</p> <p>4.14.Mban lidhje dhe koordinon me kolegët për informim dhe komunikim me publikun në institucionet e administratës publike të Kosovës;</p> <p>4.15.Menaxhon aspektet e komunikimit dhe informimit të publikut.Kryen detyra të tjera të caktuara nga Kryeshef/ja Ekzekutive në përputhje me mandatin dhe përshkrimin e vendit dhe detyrave.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b><br/><b>Divizioni për Legjislacion</b></p> <p>1.Numri i të punësuarve në Divizionit për</p> | <p>materials and press releases;</p> <p>4.11.Keeps in touch and responds to questions, media researches, individuals and different organizations via press conferences, e-mail or telephone;</p> <p>4.12.Manages, updates and engages with users of social media such as Twitter and Facebook;</p> <p>4.13.Assists and coordinates special events such as conferences, exhibitions, etc.;</p> <p>4.14.Keeps in touch and coordinates with colleagues for information and communication with public in public administration institutions in Kosovo;</p> <p>4.15.Manages public communication and information aspects. Performs other duties assigned by the Chief Executive Officer in compliance with the mandate and description of position and duties.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b><br/><b>Division for Legislation</b></p> <p>1. Number of employees in the Division for</p> | <p>materijale i saopštenje za medije;</p> <p>4.11.Održava odnos i odgovara na pitanja, istraživanja medija, lica i različitih organizacija putem konferencije za štampu, e-maila ili telefona;</p> <p>4.12.Upravlja, ažurira i angažuje se sa korisnicima socijalnih medija kao Twitter i Facebook;</p> <p>4.13.Pomaže i koordinira posebna dešavanja kao što su konferencije, izložbe, itd.;</p> <p>4.14.Održava odnose i koordiniše sa kolegama za informisanost i komunikaciju sa javnošću u institucijama javne uprave Kosova;</p> <p>4.15.Upravlja aspekte komunikacije i informisanja javnosti. Vršiti ostale obaveze određene od strane Izvršnog/e šefa/ice u skladu sa opisom radnog mesta i obaveza.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b><br/><b>Divizija za zakonodavstvo</b></p> <p>1.Broj zaposlenih u Divizija za</p> |
|--|--|--|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>Legjislacion është kater (4) zyrtarë.</p> <p>2.Në kuadër të Divizionit për Legjislacion bëjnë pjesë:</p> <p>2.1. Udhëheqësi/ja e Divizionit për Legjislacion;</p> <p>2.2. Zyrtari/ja e lartë për Legjislacion;</p> <p>2.3. Zyrtar/e për legjislacion;</p> <p>2.4. Zyrtar/e për legjislacion.</p> <p>3.Divizioni për Legjislacion udhëhiqet nga Udhëheqësi/ja i/e e Divizionit për Legjislacion dhe raporton tek Kryeshefi/ja i/e ABGJ-së.</p> <p>4.Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit/es së Divizionit për Legjislacion përfshijnë:</p> <p>4.1.Koordinon dhe merr pjesë në hartimin e akteve normative në bashkëpunim të ngushtë me Kryeshefin/en Ekzekutive, si dhe divizionet e tjera nga fushëveprimtaria e Agjencisë;</p> <p>4.2.Propozon ndryshimin dhe/apo plotësimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, si dhe masave të tjera për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore;</p> <p>4.3.Propozon masa për zbatimin e</p> | <p>Legislation is for (4) officers.</p> <p>2.The Division for Legislation consists of the following:</p> <p>2.1.Head of the Division for Legislation;</p> <p>2.2. Senior Legislation Officer;</p> <p>2.3. Legislation Officer;</p> <p>2.4. Legislation Officer.</p> <p>3.Division for Legislation shall be led by the Head of Division for Legislation and shall report to the Chief Executive Officer of AGE.</p> <p>4.Duties and responsibilities of the Head of Division for Legislation:</p> <p>4.1.Coordinates and participates in drafting normative acts in close cooperation with Chief Executive Officer, as well as other Divisions within the scope of the Agency;</p> <p>4.2.Proposes the amendment and/or supplement of laws and bylaws, as well as other measures for implementation of the law on gender equality;</p> <p>4.3.Proposes measures for implementation</p> | <p>zakonodavstvo je cetri (4) službenika.</p> <p>2.U okviru Divizije za Zakonodavstvo su:</p> <p>2.1.Rukovodilac/teljka Divizije za zakonodavstvo;</p> <p>2.2. Visoki/a zvaničnik/ca za zakonodavstvo;</p> <p>2.3. Službenik za zakonodavstvo;</p> <p>2.4. Službenik za zakonodavstvo.</p> <p>3.Divizija za zakonodavstvo se vodi od strane Rukovodioca/teljke Divizije za zakonodavstvo i izveštava Izvršnom/oj šefu/ici ARP-a.</p> <p>4.Obaveze i odgovornosti Rukovodioca/teljke Divizije za zakonodavstvo obuhvataju:</p> <p>4.1.Koordiniranje i učestvovanje u izradi normativnih akata u bliskoj saradnji sa Izvršnim/om šefom/icom, kao i ostalim divizijama iz delokruga Agencije;</p> <p>4.2.Predlaže izmene i/ili dopune zakona i podzakonskih akata, kao i ostalih mera za sprovođenje Zakona o ravnopravnosti polova;</p> <p>4.3.Predlaže mere za sprovođenje</p> |
|---|---|---|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore;</p> <p>4.4 Në bashkëpunim me divizionet tjera , njësitë apo personat përgjegjës për hartimin e projekt-akteve normative, siguron përputhshmërinë e akteve normative të propozuara nga ABGJ dhe/apo Ministritë përkatëse me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe normat ndërkombëtare mbi barazinë gjinore;</p> <p>4.5.Ofron opinione ligjore dhe këshilla juridike për mekanizmat institucionalë për barazi gjinore nga fushëveprimi i ABGJ-së;</p> <p>4.6.Në bashkëpunim me Divizionet e tjera udhëheq procesin e përgatitjes së hartimit për raportin vjetor për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore;</p> <p>4.7.Koordinon me Zyrën Ligjore në ZKM për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin e Programit Legjislativ dhe aktiviteteve të tjera që ndërlidhen me procesin e hartimit të legjislacionit në fushën e barazisë gjinore</p> <p>4.8.Identifikon probleme të zbatimit të akteve normative;</p> | <p>of international agreements and acts related to gender equality;</p> <p>4.4.In cooperation with other divisions, units or persons responsible for developing draft normative acts, ensures the compliance of normative acts proposed by AGE and/or relevant ministries with the legislation applicable in the Republic of Kosovo and international norms on gender equality;</p> <p>4.5.Provides legal opinions and advices for institutional mechanisms for gender equality within the scope of AGE;</p> <p>4.6.In cooperation with other Divisions, leads the process of drafting the annual report on implementation of the law on gender equality;</p> <p>4.7.Coordinates with the Legal Office within OPM to prepare, monitor and report the Legislative Programme and other activities related to the process of drafting the legislation in the field of gender equality;</p> <p>4.8.Identifies the problems in</p> | <p>međunarodnih sporazuma i akata koji se tiču ravnopravnosti polova;</p> <p>4.4.U saradnji sa ostalim divizijama, jedinicama ili licima za izradu nacrt-normativnih akata, obezbeđuje usklađenost normativnih akata predloženih od strane ARP-a i/ili relevantnih ministarstva sa primenjivim zakonodavstvom u Republici Kosovo i međunarodnim načelima o ravnopravnosti polova;</p> <p>4.5.Pružā pravna mišljenja i pravne savete za institucionalne mehanizme za ravnopravnost polova iz delokruga ARP-a;</p> <p>4.6.U saradnji sa ostalim divizijama vodi proces pripreme i izrade godišnjeg izveštaja za sprovođenje Zakona o ravnopravnosti polova;</p> <p>4.7.Koordinira zajedno sa pravnom kancelarijom u KP za pripremanje, praćenje i izveštavanje zakonodavnog programa i ostalih aktivnosti koje se nadovezuju sa procesom izrade zakonodavstva u oblasti ravnopravnosti polova;</p> <p>4.8.Identifikuje probleme sprovođenja</p> |
|--|---|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>4.9. Harton në baza vjetore plan buxhetin e divizionit në harmonizim me përgjegjësitë dhe aktivitetet që burojnë nga mandati dhe përgjegjësitë e i Divizionit dhe politikat publike dhe nisma të ndërmarra nga ABGJ apo në bashkëpunim me institucione të tjera të Kosovës apo institucione ndërkombëtare;</p> <p>4.10. Kontribuon në forcimin e aspektit të barazisë gjinorë apo instrumentave si buxheti gjinor në instrumenta publikë financiarë si Plani Buxhetor Vjetor i Kosovës, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Strategjia Kombëtare për Zhvillim, etj, përmes analizave dhe rekomandimeve në baza periodike;</p> <p>4.11. Mbikëqyr performancën e personelit të divizionit që drejton dhe ofron mbështetje profesionale për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.</p> <p>4.12. Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së KE-së si dhe të përcaktuara me legjislacionin përkatës.</p> <p>5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit/es të lartë për Legjislacion:</p> <p>5.1. Koordinon dhe merr pjesë në hartimin e akteve normative, në bashkëpunim të</p> | <p>implementing normative acts;</p> <p>4.9. Annually drafts the division's budget plan in line with responsibilities and activities deriving from the mandate and responsibilities of the Division and public policies and initiatives undertaken by AGE or in cooperation with other Kosovo institutions or international institutions;</p> <p>4.10. Contributes to the strengthening of gender equality aspect or instruments, such as gender budgeting in public financial instruments such as Kosovo Annual Budget Plan, Medium-term Expenditure Framework, National Development Strategy, etc., through periodic analysis and recommendations;</p> <p>4.11. Supervises the performance of the division staff that leads and provides professional support for fulfilment of their duties and responsibilities.</p> <p>4.12. Performs other duties upon the request of CEO and as determined in the relevant legislation.</p> <p>5. Duties and responsibilities of the Senior Legislation Officer:</p> <p>5.1. Coordinates and participates in drafting</p> | <p>normativnih akata;</p> <p>4.9. Izrađuje na godišnjoj osnovi plan budžeta divizije u skladu sa odgovornostima i aktivnostima koje proizlaze iz mandata i odgovornosti divizije i javnih politika kao i inicijativa preduzetih od strane ARP-a ili u saradnji sa ostalim institucijama Kosova ili međunarodnim institucijama;</p> <p>4.10. Doprinosi u ojačanju aspekta ravnopravnosti polova ili instrumenata kao rodno budžetiranje u javnim instrumentima kao što su godišnji budžetski plan Kosova, srednjoročni okvir rashoda, nacionalna strategija za razvoj, itd., putem analiza i preporuka periodično;</p> <p>4.11. Nadgleda učinak osoblja divizije koju vodi i pruža stručnu podršku za ispunjavanje njihovih obaveza i odgovornosti.</p> <p>4.12. Vršiti i ostale obaveze prema zahtevu IŠ kao i one određene relevantnim zakonodavstvom.</p> <p>5. Obaveze i odgovornosti Visokog/e Službenika/ce za zakonodavstvo:</p> <p>5.1. Koordinira i učestvuje u izradi normativnih akata, u bliskoj saradnji sa</p> |
|---|---|---|



|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>ngushtë me Shefin/en e Divizionit për Legjislacion, me Kryeshefen Ekzekutive dhe me Departamentet e ABGJ-së;</p> <p>5.2. Propozon ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe masave të tjera për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore;</p> <p>5.3. Ofron ndihmë për strukturat organizative të agjencisë në identifikimin e çështjeve që duhen normuar;</p> <p>5.4. Propozon masa për zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore;</p> <p>5.5. Harton propozim-vendime dhe propozime të materialeve të ndryshme të kërkuara nga udhëheqësi/ja dhe KE;</p> <p>5.6. Kryen punë të tjera të caktuara nga udhëheqësi i tij/saj i drejtpërdrejtë dhe nga Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e në përputhje me mandatin dhe përshkrimin e vendit dhe detyrave të punës.</p> <p>5.7. Në bashkëpunim me divizionet, njësitë apo zyrtarët përgjegjës për hartimin e projekt-akteve normative, siguron përputhshmërinë e akteve normative të</p> | <p>normative acts, in close cooperation with the Head of Division for Legislation, Chief Executive Officer and AGE Departments;</p> <p>5.2. Proposes the amendment and supplementation of acts, bylaws and other measures for implementation of the law on gender equality;</p> <p>5.3. Provides assistance to organizational structures of the agency in identifying issues to be regulated;</p> <p>5.4. Proposes measures for implementing international agreements and acts related to gender equality;</p> <p>5.5. Prepares draft-decisions and proposals of various materials as required by the supervisor and CEO;</p> <p>5.6. Performs other works assigned by his/her immediate manager and Chief Executive Officer in compliance with the mandate and description of position and duties.</p> <p>5.7. In cooperation with divisions, units or officers responsible for preparing draft normative acts, ensures compliance of normative acts proposed by AGE and</p> | <p>šefom/icom Divizije za zakonodavstvo, sa Izvršnim/om šefom/icom i odeljenjima ARP-a;</p> <p>5.2. Predlaže izmene i dopune zakona, podzakonskih akata i ostalih mera za sprovođenje Zakona o ravnopravnosti polova;</p> <p>5.3. Pruža pomoć organizacionoj strukturi agencije u identifikaciji pitanja koje treba regulisati;</p> <p>5.4. Predlaže mere za sprovođenje međunarodnih sporazuma i akata koji se tiču ravnopravnosti polova;</p> <p>5.5. Izrađuje predlog-odluke i predloge različitih materijala koje zahteva rukovodilac/teljka i IŠ;</p> <p>5.6. Vrš i druge poslove određene od strane njegovog/njenog direktnog/e rukovodioca/teljke i od strane Izvršnog/e šefa/ice u skladu sa mandatom i opisom radnog mesta i obaveza.</p> <p>5.7. U saradnji sa divizijama, jedinicama ili odgovornim službenicima za izradu nacrta normativnih akata, obezbeđuje usklađenost normativnih akata predloženih</p> |
|--|---|--|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>propozuara nga ABGJ dhe Ministrinë përkatëse me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës si dhe ligjin për barazi gjinore</p> <p>6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit/es për Legjislacion, nën udhëheqjen e udhëheqësit/es së Divizionit për Legjislacion:</p> <p>6.1. Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është e saktë si në aspektin gjuhësor ashtu edhe teknik;</p> <p>6.2. Sipas kërkesës dhe udhëzimeve jep opinione ligjore dhe bënë hartimin e projektmarveshjeve, projekt vendimeve dhe projektakteve tjera;</p> <p>6.3. Bashkëpunon dhe ofron opinione ligjore dhe këshilla juridike për mekanizmat institucionalë për barazi gjinore nga fushëveprimi i ABGJ-së;</p> <p>6.4. Ofron opinione ligjore dhe këshilla juridike për mekanizmat institucionalë për barazi gjinore nga fushëveprimi i ABGJ-së;</p> <p>6.5. Përcjell zbatimin e ligjeve nga aspekti gjinor dhe identifikon shkaqet për moszbatimin e akteve normative;</p> | <p>relevant ministries with the applicable legislation in the Republic of Kosovo, as well as the law on gender equality.</p> <p>6. Duties and responsibilities of the Legislation Officer, under the directions of the Head of Division for Legislation shall:</p> <p>6.1. Ensure that the content and form is accurate both in the lingual as well as in the technical aspect;</p> <p>6.2. Based on the request and instructions, provides legal opinion and develops draft agreements, draft decisions and other draft acts;</p> <p>6.3. Cooperates and provides legal opinions and legal advices for institutional mechanisms for gender equality within the scope of AGE;</p> <p>6.4. Provides legal opinions and advices for institutional mechanisms for gender equality from the scope of AGE;</p> <p>6.5. Follows the implementation of laws in terms of gender and identifies causes for failure to implement normative acts;</p> | <p>od strane ARP-a i relevantnih ministarstva sa zakonodavstvom primenjenim u Republici Kosovo kao i zakonom za ravnopravnost polova.</p> <p>6. Obaveze i odgovornosti Službenika/ce za Zakonodavstvo, pod vodstvom rukovodioca/teljke Divizije za zakonodavstvo:</p> <p>6.1. Brine se da sadržaj i oblik normativnog akta bude tačan u jezičkom kao i u tehničkom pogledu;</p> <p>6.2. Prema zahtevu i smernicama daje pravna mišljenja i vrši izradu nacrta sporazuma, nacrta odluka kao i ostale nacrte akata.</p> <p>6.3. Saraduje i pruža pravna mišljenja i pravne savete za institucionalne mehanizme za ravnopravnost polova iz delokruga ARP</p> <p>6.4. Pruža pravna mišljenja i pravne savete za institucionalne mehanizme za ravnopravnost polova iz delokruga ARP-a;</p> <p>6.5. Prati sprovođenje zakona sa rodnog pogleda i identifikuje uzroke ne sprovođenja normativnih akata;</p> |
|---|--|--|

|  |   |  |
|--|---|--|
